Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-325
Datë: 30.08.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.08.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Kolegji AAB- Qendra Gjermane e Kompetencës në Prishtinë me adresë Zona Industriale Fushë Kosovë, për periudhën 25.08.2017 deri 25.08.2020 me kualifikimet:

   1.1. Shitës, Niveli IV sipas KKK me 60 kredi të AAP.
   1.2. Oficer Doganor, Niveli IV sipas KKK me 60 kredi të AAP.
   1.3. Agjent/Agjente turistik/e dhe e informimit për udhëtime, Niveli IV sipas KKK me 60 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

   Shitës

   2.1. Plani mësimor i programit shitës përmban modulet obligative dhe zgjedhore, mirëpo duket se shpërndarja e fondit të orëve nuk është shumë profesionale, sepse thuhet të jenë tri module zgjedhore, por nëse kandidati zgjedh vetëm një modul zgjedhor atëherë nuk përmbushet kërkesa e nevojshme për të plotësuar fondin e orëve në 600 sa kërkohet në program.

   Oficer Doganor

   2.1. Plotësimi i stafit mësimdhënës me profesionist të lëmive sipas kualifikimit dhe moduleve.

   2.2. Sigurimi i teksteve bazike për mësimdhënie.

   2.4. Lista e moduleve të obliguara të përmbajë 80% të moduleve sipas Standardit të Profesionit.

2.5. Hartimi i politikave dhe proceduarave për të gjitha proceset e punës duke filluar nga pragu minimal, kriteret për pranimin e kandidatëve për AAB/QGJK dhe rregullore tjera, dukë adaptuar vetëm për Qendrën e trajnimeve dhe të jenë dokument i veçantë.

Agjentë/Agjente turistike dhe e informimit për udhëtime

2.1. Bashkëpunimi me biznesin, posaçërisht ne fushën e ofrimit të punës praktike duhet të zgjerohet duke bërë marrëveshje edhe me Qendrat Informative Turistike apo biznese tjera që zhvillojnë aktivitete të ngjashme.

2.2. Qendra duhet të dëshmojë se ka siguruar sistem kompjuterik të distribuimit (anglisht GDS si Amadeus, Galileo) përdorimi i së cilit është parapare në pikën 5.5. në Aplikacionin për validim dhe RM3, 4 dhe 5 në Programin e kursit.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datat 01.09.2017 dhe 31.12.2017 sipas raporteve të jashtme vlerësuese për secilin kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:
   - AAB/QGJK ;
   - AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së